



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Nr. 1558 / prot.
11

Tiranë, më 06.04.2021

Lënda: Përcillen vendime të AMA-s

Z.ILIRJAN CELIBASHI,
KOMISIONERI SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4,
Tiranë

Në cilësinë e entit rregullator që monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA) dhe në zbatim të përcaktimeve të Metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive, bashkëlidhur po ju dërgojmë:

- Vendimin e AMA-s, nr. 51, datë 06.04.2021, "Për shqyrtimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 26 mars 2021 - 03 prill 2021", si dhe tabelat referuese.
- Vendimin e AMA-s, nr. 52, datë 06.04.2021 "Për përcaktimin e listës së subjekteve OSHMA që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore, në datat 04 prill 2021 - 10 prill 2021".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.


KRYETARI
Gentian SALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 1559 prot.,

Datë 06 . 04 .2021

VENDIM

NR. 51, DATË 06.04.2021

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË MBULIMIT TË FUSHATËS
ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË PËR PERIUdhËN 26 MARS 2021 - 03 PRILL 2021**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26 mars 2021 - 03 prill 2021

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 77 - 84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”,

VËREN SE:

Në zbatim të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, AMA është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat audiovizive.

Sipas kësaj dispozite ligjore:

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, (AMA). Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.



2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ të KQZ-së nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.
3. Jo me vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.
4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.
4. KQZ-ja urdhëron korrigjimin e sjelljes për operatorët radiotelevizivë ose subjektet zgjedhore, ose, sipas rastit, vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit, si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të KQZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 ka miratuar Metodologjinë e Monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, akt në të cilin parashikohen procedurat dhe teknikat që duhet të ndjekë AMA gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore.

Në nenet 9 dhe 10 të Metodologjisë përcaktohet përmbajtja e raporteve të monitorimit dhe paraqitja e tyre në KQZ. Në pikën 2 të nenit 10, po të këtij akti, parashikohet se “*AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiore dhe cilësore), minimalisht njëherë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë*”.

Përpara fillimit të fushatës zgjedhore si dhe në vazhdimësi të saj, AMA ka komunikuar në mënyrë periodike me gjithë OSHMA-të, (shkresa zyrtare, publikime në adresën zyrtare në web, kontakte të drejtpërdrejta etj) për t’u kujtuar rëndësinë e zbatimit të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ.

Bazuar në kapacitetet teknike të monitorimit, janë monitoruar përmbajtjet programore të 36 OSHMA-ve (36 kanale).

Nga këto, 27 kanale (TV 23 dhe radio 4) janë të përhershme në monitorim, ndërsa 9 subjekte janë përfshirë sipas përzgjedhjes nga ana e AMA-s, raportuar në KQZ.

Subjektet e përfshira në monitorim ushtrojnë veprimtari audiovizive mbështetur në platformë tokësore, satelitore, kabllore dhe IPTV dhe internet tv.

Në zbatim të Metodologjisë së monitorimit, AMA ka përcjellë çdo ditë në KQZ, raportin ditor të monitorimit, me të dhënat e mëposhtme:

- Kohën e monitorimit të secilit prej OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet nga ora 08:00 -00:00.
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor
- Hapësirën për çdo aktor politik
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative
- Transmetimet live
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatic të kandidatëve.

Në raportet ditore të monitorimit të depozituara në KQZ, janë prezantuar problematikat e konstatuara në subjektet e monitoruara.



Në këtë raport përmbledhës për periudhën 26 mars 2021-03 prill 2021, paraqiten tregues të tabelizuar si dhe propozime përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi:

- Depozitimin në AMA të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA;
- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e lajmeve, hapësirën për çdo aktor politik;
- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e emisioneve;
- Reklammat politike;
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatik të kandidatëve.

Depozitimi i regjistrimeve në AMA

Në pikën 6 të nenit 85 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se: *“Radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të saj”.*

Detyrimi për depozitimin e transmetimeve të çdo dite, parashikohet në metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive. Sipas tij: *“OSHMA-të vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese.”*

Subjektet audiovizivë:

- TV Skampa
- TV Adria Net
- TV Channel 1
- TV Kopliku
- TV Antena Nord
- TV Klaudiana
- TV Channel 7
- TV Jug
- TV Gold
- TV Glob
- TV Puka
- TV 4,
- TV Mati, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021.

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Informojmë se OSHMA-të:

- TV Bulqiza
- TV Alpo



- TV Rozafa
- TV RE.AL
- TV Apollon
- TV Berati
- TV Sot 7
- TV Star Plus
- TV Best Channel
- TV 6+1
- One TV Vlora
- TV Saranda
- TV Lobi
- TV Kukësi
- Zjarr TV, kanë depozituar regjistrime jo për të gjithë ditët e kësaj periudhe.

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, për respektimin e plotë të këtij detyrimi.

Monitorimi i edicioneve informative

Neni 81 i Kodit Zgjedhor parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive privatë .

Në tabelën nr. 1, bashkëlidhur pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike në edicionet informative.

Propozim:

Referuar të dhënave të Tabelës nr. 1, për edicionet e lajmeve, AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të e mëposhtme të bëjnë kompesimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim:

Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD	PDIU
1	RTSH 1	35 min	-	34 min	40 min	40 min
2	RTSH 2	5 min	-	4 min	7 min	7 min
3	TV Klan	57 min	-	61 min	73 min	73 min
4	TV Top Channel	7 min	-	20 min	20 min	20 min
5	TV Vizion Plus	33 min	-	39 min	44 min	47 min
6	RTSH 24	22 min	-	20 min	23 min	23 min
7	Klan Plus	26 min	-	17 min	25 min	25 min
8	Klan News	128 min	-	75 min	105 min	105 min
9	Top News	35 min	-	41 min	48 min	48 min
10	Kanal 7	15 min	-	14 min	19 min	19 min



11	News 24	20 min	-	28 min	59 min	57min
12	ABC News	-	4 min	18 min	25 min	25 min
13	RTV Ora	17 min	-	12 min	22 min	23 min
14	Report TV	98 min	-	59 min	75 min	80 min
15	TV Scan	9 min	-	49 min	49 min	49 min
16	TV Ora News	22 min	-	9 min	24 min	26 min
17	TV Shijak	-	38 min	-	85 min	85 min
18	Euronews Balkans	-	5 min	25 min	49 min	49 min
19	Fax News	25 min	-	14 min	29 min	36 min
20	Syri TV	-	25 min	43 min	73 min	73 min
21	TV Apollon	21 min	-	174 min	174 min	174 min
22	TV Alpo	35 min	-	-	35 min	35 min
23	A2 CNN	18 min	-	19 min	45 min	47 min
24	TV Bulqiza	-	16 min	19 min	29 min	34 min
25	TV Berati	11 min	-	18 min	18 min	18 min
26	RE.AL	-	13 min	50 min	36 min	50 min
27	MCN TV	24 min	-	26 min	24 min	26 min
28	TV Rozafa	28 min	-	29 min	65 min	65 min
29	TV Skampa	9 min	-	49 min	49 min	49 min
30	Zjarr TV	-	10 min	-	55 min	55 min
31	Adria Net	-	-	8 min	17 min	17 min

AMA ka identifikuar dhe ka raportuar në informacionet ditore për KQZ-së se subjekti TV Bulqiza ka përfshirë në përmbajtjet e saj audiovizive dhe transmetimin e edicioneve informative të një OSHMA-je tjetër (datat 28, 29, 31 mars, 1, 2 dhe 3 prill 2021).

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së që t'i drejtohet OSHMA-së për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër.

Monitorimi i emisioneve

Në tabelën Nr. 2, (Emisionet), jepen të dhëna përmbledhëse për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021 mbi kohën që iu kanë dhënë OSHMA-të subjekteve politike gjatë emisioneve dedikuar fushatës zgjedhore.

Transmetimi i reklamave politike

Neni 84 i Kodit Zgjedhor parashikon kushtet e transmetimit të reklamave politike. Në këtë dispozitë parashikohet se:

“4. ... Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. ...”

7. Reklammat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.”



Në tabelën Nr. 3, jepen të dhëna përmbledhëse për transmetimin e reklamave politike në periudhën 26.03.2021 - 03.04.2021.

Lidhur me respektimin e parashikimeve të mësipërme, sikundër është raportuar çdo ditë në KQZ, ka pasur disa problematika me zbatimin e kërkesave të Kodit Zgjedhor. AMA ka raportuar në ditët e para të fushatës raste të transmetimit të reklamave të paidentifikuara.

Kështu ka qenë rasti i OSHMA-ve, Top Channel, në datat 26, 28, 29 mars 2021, si dhe Kanali 7 në datat 26 -27 mars 2021. Por në ditët vijuese në procesin e monitorimit nuk është identifikuar ndonjë rast tjetër.

Sa i përket orareve të transmetimit të reklamave politike, për periudhën 26.03.2021 - 03.04.2021, më poshtë paraqiten OSHMA-të, që nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit:

- TV Klan (data 26 mars 2021)
- TV Vizion Plus (data 29 mars 2021)
- Klan News (datat 27, 30, 31 mars, 2 prill 2021)
- ABC News (data 26 mars 2021)
- RTV Ora (data 26 mars 2021)
- Syri TV (data 27, 28 mars 2021)
- A2 CNN (data 31 mars 2021)
- TV Shijak (datat 26, 27, 28, 29, 30, 31 mars, 1, 2 dhe 3 prill 2021)
- TV Apollon (data 28, 29, 30 mars, 1, 2 dhe 3 prill 2021)
- RE.AL (datat 26, 27, 28, 29, 30, 31 mars, 1, 2 prill 2021)

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.

AMA ka konstatuar raste të transmetimit të reklamës politike brenda edicionit të lajmeve nga OSHMA-të, Klan News, Alpo dhe RE.AL (të raportuara nga AMA në KQZ në datat 31 mars, 1, 2 dhe 3 prill 2021).

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve. (të cilat nuk mund të sponsorizohen).

Referuar të dhënave po të kësaj table, rezulton se subjekti audioviziv RE.AL ka tejkaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues, pasi ka transmetuar 283.6 minuta reklamë politike për Partinë Bindja Demokratike. Sipas pikës 9 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, koha e transmetimit të reklamave për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore.

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-së të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për këtë subjekt zgjedhor.

Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë

Sa i takon vlerësimin gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën elektorale, (pasqyruar përmbledhtazi në Tabelën nr. 4), për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021, përveç OSHMA-ve RTSH 1, Shijak TV, Apollon, Rozafa, MCN dhe Adria Net, të cilat kanë pasur përfaqësim të balancuar pjesa tjetër e OSHMA-ve ka disbalancë për këtë tregues.

OSHMA-të kombëtare dhe lokalë/rajonale që mbulojnë më shumë se 48% të popullsisë rezultojnë se nuk kanë respektuar raportin e përfaqësimit gjinor në pasqyrimin e fushatës zgjedhore.

Respektimi i përfaqësimit gjinor në fushatën elektorale duhet të reflektojë realisht angazhimin dhe kontributin e femrave në shoqërinë shqiptare, në dinamikën e proceseve të demokratizimit dhe integritimit.

Propozim:

AMA i propozon KQZ-së që t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, të jenë më të ndjeshëm dhe të vëmendshëm në respektimin e këtij kriteri.

Publikimi i sondazheve zgjedhore

Nisur nga monitorimi i respektimit të kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor (publikimi i sondazheve zgjedhore), për periudhën 26.03.2021 deri më 03.04.2021 në sondazhet që janë pasqyruar në përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të nuk është identifikuar ndonjë rast ku janë shkelur kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Neni 78 i Kodit Zgjedhor përcakton se: *“Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.”*

Bashkëlidhur, këtij vendimi gjenden tabelat referuese, të cilat janë të bazuara në raportimet ditore që AMA ka dorëzuar pranë KQZ-së dhe që janë publikuar periodikisht në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

Në pikën 2 të nenit 10 të metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive, parashikohet se: *“AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiore dhe cilësore), minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë”,*

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 77-84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”,



VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në për periudhën 26 mars 2021- 03 prill 2021.
2. T'i propozojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:
 - 2.1 Marrjen e masës administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor ndaj OSHMA-ve që nuk kanë depozituar në AMA, përmbajtjet e regjistruara audiovizive.
 - 2.2 T'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve që kanë depozituar pjesërisht në AMA përmbajtjet e regjistruara audiovizive, për respektimin e plotë të këtij detyrimi.
 - 2.3 T'i kërkojë OSHMA-ve që rezultojnë me disbalancë në edicionet informative kompensimin e kohës së transmetimit.
 - 2.4 T'i kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.
 - 2.5 T'i kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve.
 - 2.6 T'i kërkojë OSHMA-së, RE.AL, të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për një subjekt zgjedhor, për shkak të tejkalimit të kufirit të kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues.
 - 2.7 T'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, të jenë më të ndjeshëm dhe të vëmendshëm në respektimin e raportit të përfaqësimit gjinor.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e vendimit të mësipërm, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 1560 prot.,

Datë 06.04.2021

VENDIM

NR. 52, DATË 06.04.2021

PËR

**PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE OSHMA QË DO TË MONITROHEN
PËR MBULIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE NË DATAT 04 PRILL 2021 -10
PRILL 2021**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA, kryesisht

Objekt: Përcaktimi i listës së subjekteve OSHMA që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 04 prill 2021 -10 prill 2021

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 77-84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 :Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive",

VËREN SE:

AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator që funksionon sipas parashikimeve të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, referuar ndryshimeve në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat audiovizive.

Sipas nenit 85 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar: *Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, (AMA). Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.*



KQZ, me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 ka miratuar metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, akt në të cilin parashikohen procedurat dhe teknikat që duhet të ndjekë AMA gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore.

Referuar këtij akti: “*Monitorimi i fushatës zgjedhore nga OSHMA-të kryhet në të gjithë territorin e vendit ku zhvillohen zgjedhjet. AMA monitoron zbatimin e rregullave të sanksionuara në Kodin Zgjedhor dhe të akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Radiotelevizioni Publik Shqiptar dhe OSHMA-të private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë fushatës zgjedhore. Regjistrimet ruhen për një periudhë 10-mujore pas përfundimit të zgjedhjeve dhe vihen në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesën e këtij institucioni.*”

Në nenin 6 të aktit parashikohen kriteret mbi të cilat do të përcaktohen subjektet OSHMA, përmbajtjet e të cilëve do të monitorohen.

Monitorimi i operatorit publik dhe OSHMA-ve private me shtrirje rajonale që mbulojnë më pak se 48% të popullsisë bëhen me përzgjedhje në bazë të këtyre kriterëve:

- a) Zona e ofrimit të shërbimit (mbulimi gjeografik);
- b) Audiencia;
- c) Oraret e transmetimit;
- d) Formatin e përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, i përgjithshëm/tematik;
- e) Lloji i medias, audiencia e synuar nga kjo lloj media ne publik/ aktoret politike.

Në këtë kategori janë të përfshirë 26 OSHMA/kanale të licencuar për mbulim lokal dhe rajonal.

AMA konstaton se aplikimi i kriterit “*Audiençë*” dhe “*Audiencia e synuar nga kjo lloj media në publik/ aktorët politike*”, nuk është i aplikueshëm në kushtet aktuale. Në këto kushte, kriteri kryesor që mbahet në konsideratë është mbulimi gjeografik, duke përfshirë në monitorim subjekte të licencuar për zona të ndryshme të vendit, me qëllim sigurimin e të dhënave për të gjithë territorin e vendit. Lidhur me karakterin e programit, me përjashtim të një OSHMA (Star Plus), të gjithë OSHMA-të kanë karakter gjeneralist.

OSHMA/kanalet që mbulojnë më pak se 48% të popullsisë janë:

Nr	Kanali	Territori	Programacioni
1	RTSH Korça	Lokal (Korçë)	Gjeneralist
2	RTSH Gjirokastra	Lokal(Gjirokastër)	Gjeneralist
3	RTSH Kukësi	Lokal (Kukës)	Gjeneralist
4	TV Sot 7	Lokal (Pogradec)	Gjeneralist
5	TV Rozafa Motiv	Rajonal (Shkodër dhe Lezhë)	Gjeneralist
6	TV Star Plus	Lokal (Shkodër)	Informativ
7	TV Channel 1	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
8	TV Kopliku	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
9	TV Antena Nord	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
10	TV Klaudiana	Lokal(Elbasan)	Gjeneralist
11	TV Skampa	Lokal (Elbasan)	Gjeneralist
12	TV Best Channel	Lokal (Elbasan)	Gjeneralist
13	TV 6+1	Lokal (Vlorë)	Gjeneralist
14	One TV Vlora	Lokal (Vlorë)	Gjeneralist
15	TV RE.AL	Lokal (Vlorë)	Gjeneralist



16	TV Apollon	Rajonal (Fier dhe Vlorë)	Gjeneralist
17	TV Saranda	Lokal (Vlorë)	Gjeneralist
18	TV Alpo	Lokal(Gjirokaster)	Gjeneralist
19	TV Channel 7	Lokal (Gjirokastër)	Gjeneralist
20	TV Mat	Lokal (Dibër)	Gjeneralist
21	TV Bulqiza	Lokal (Dibër)	Gjeneralist
22	TV Lobi	Lokal (Korçë)	Gjeneralist
23	TV Berati	Lokal (Berat)	Gjeneralist
24	TV Glob	Lokal (Berat)	Gjeneralist
25	TV Kukësi	Rajonal (Kukës, Lezhë, Tiranë, Durrës)	Gjeneralist
26	TV Jug	Lokal (Fier)	Gjeneralist

Nga kanalet/programet e cituara më lart:

- 14 kanale me licencë lokale mund të regjistrohen nga studio e regjistrimit pranë AMA.
- 12 kanale nuk regjistrohen dot nga studio e AMA-s, të cilat do të dërgojnë në autoritet regjistrimet për programet e transmetuara..

Një tjetër kategori subjektësh, OSHMA, janë edhe subjektet e pajisura me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor, internet, IPTV etj. Në total janë të pajisur me autorizim 18 subjekte, nga të cilët 7 subjekte transmetojnë edicione informative, duke qenë se karakteri i programacionit të tyre është gjeneralist.

Subjektet OSHMA, të pajisur me autorizim, që do të përfshihen në monitorim janë:

1. Zjarr TV - regjistrohet nga studio e monitorimit;
2. Adria Net - regjistrohet nga studio e monitorimit;
3. TV Gold - regjistrohet nga studio e monitorimit;
4. Net 3 Digital, nuk regjistrohet nga studio e monitorimit;
5. TV Lezha, nuk regjistrohet nga studio e monitorimit;
6. TV Puka, nuk regjistrohet nga studio e monitorimit;
7. TV 4+, nuk regjistrohet nga studio e monitorimit.

Për javën e dytë të monitorimit, datat 04 prill 2021 - 10 prill 2021, AMA propozon që të përfshihen në monitorim, subjektet OSHMA, të mëposhtme:

Nr.	OSHMA
1	TV Mati
2	TV Channel 7
3	Star Plus
4	TV 6+1
5	TV Best
6	One TV Vlora
7	TV Glob
8	Belsh TV
9	TV Kukësi



Në zbatim të nenit 6, pika 4 të Metodologjisë për monitorimin e medias audio dhe audiovizive, sipas të cilit: *“Në zonat kryesore gjeografike të populluara nga pakica kombëtare, AMA monitoron edhe OSHMA lokale, në bazë të përzgjedhjeve...”*, lista e propozuar e respekton edhe këtë kriter. Pas konsultimit në faqen zyrtare të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, strukturë e ngritur në zbatim të ligjit nr. 96/2017, *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, rezultoi që pakicat kombëtare (greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare) janë të shpërndara pothuajse në gjithë territorin e vendit.

Në zbatim të nenit 6, pika 3 të po kësaj metodologjie: *“AMA me qëllim monitorimin e gjithë OSHMA-ve, bazuar në kapacitetet dhe mundësitë teknike për OSHMA-te të cilat do të monitorohen sipas pikave 1/b dhe 2/b i rekomandon çdo ditë të hënë, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numrin e kanaleve/ OSHMA-ve që do të monitorohen dhe të shpjegojë arsyet e kësaj përzgjedhje.”*

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nenet 77-84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së *“Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”*,

V E N D O S I:

1. T'i rekomandojë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, listën e subjekteve OSHMA që mbulojnë më pak se 48% të popullsisë, që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 03 prill 2021 – 10 prill 2021, si më poshtë:

Nr.	OSHMA
1	TV Mati
2	TV Channel 7
3	Star Plus
4	TV 6+1
5	TV Best
6	One Tv Vlora
7	TV Glob
8	Belsh TV
9	TV Kukësi

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e vendimit të mësipërm, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian SALA
Zëvendëskryetar: Sami NEZAJ
Anëtarë: Gledis GJIPALI
Suella MUSTA

TABELA NR.1

Subjekti	Apollon	Shijak TV	Rozafa tv	Klan News	Syri Tv	Zjarr Tv	Report TV	Re Al	News 24	KlanTv	Euronew	Alpo TV	A2 CNN	Skampa	Scan	Top News	Vizion P	Fax News	Budiqi
PS Partia Socialiste	348,2	132,4	131,33	209,9	122,87	100,65	160,17	87,58	118,5	146,6	93,63	106	95,22	98,57	123,6	97,48	94,43	73,45	52,
PD Partia Demokratike	326,83	170,85	103,05	81,53	147,75	110,43	62,03	100,6	97,93	89,57	97,98	70,22	77,18	89,65	62,33	61,82	60,82	48,27	68,
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	0	88,57	36,85	29,38	29,9	51,52	21,05	0	30,47	12,17	24,52	41	28,27	0	11,25	7,67	7,77	22,02	15,
PR Partia Republikane Shqiptare	0	16,75	85,17	0	6,73	16,22	22,1	0	0	0	0	0	2,53	0	0	0	0	9	7,
BD Partia Binda Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	63,32	0	0,75	0	0	1,67	2,75	0	0	0	0	0
LN Lëvizja për Ndryshim	0	0	0	0	0	0	4,52	13,8	0	0	0	0	2,87	3	0	0	2,77	7,47	4,
PSD Partia Social Demokratike	0	0	0	0	3,4	2,35	1,15	0	1	0	1,27	0	0,97	4,9	0	6,43	0	3,08	
PAA Partia Agrare Ambientaliste	0	19,2	0	0	2,5	0	7,13	0	4,83	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PBPPSH Partia Bashkimi Popullor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4,35	0	0	0
PDIU Partia Drejtësi, Integrim dh	0	0	0	0	0	0	0	0	2,22	0	0	0	0,58	0	0	0	0	0,68	
PBDNU Partia për Bashkimin dhe	0	0	0	0	1,67	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PDS Partia Democracia Sociale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PD -AN Partia Demokratike - Alet	0	0	0	1,05	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Parti të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	675,03	427,77	356,4	321,86	314,82	281,17	278,15	265,3	254,95	249,1	217,4	217,22	209,29	198,87	197,2	177,75	165,79	163,97	149,



Autoriteti Mediave Audiovizive
 Subjekti - Lajme
 Koha e plotë në minuta
 26/03/2021 - 03/04/2021



TABELA NR.1

Subjekti	RTSH 1	Abc New	Ora Net	MCN	Riv Ora	Klan Plus	Top Channel	RTSH 24	Adrianet	Kanali 7	Berati Tv	Radio Tirana	RTSH 2	Top Albania Radio	Radio Klan	Club Fm	totali
PS Partia Socialiste	81,22	46,28	53,28	53,2	45,9	51,38	43,6	45,9	34,67	37,43	37,3	20,4	15,28	3,12	3,33	0,63	2965,82
PD Partia Demokratike	45,77	50,17	31,1	28,9	28,23	25,47	36,28	24,07	32,08	22,87	25,53	15,77	9,85	1,67	2,57	1,2	2308,52
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	6,65	7,2	13,2	5,35	11,9	8,6	1,05	3,05	9,4	4,4	0,52	5,58	3,3	0	0	0	538,49
PR Partia Republikane Shqiptare	6,2	10,85	15,47	0	3,67	0	0	5,93	0	0	0	2,8	12,4	0	0	0	223,75
BD Partia Bërdia Demokratike	0	0	0	2,77	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	71,26
LN Lëvizja për Ndryshim	0	0	0	5,25	0	0	1,87	0	0	2,3	0	0	0	0	0	0	48,7
PSD Partia Social Demokrate	1,9	5,03	1,93	2,3	0,83	0	1,05	0	0	0	0	0	0	1,82	0	0	39,41
PAA Partia Agrare Ambientaliste	0	0	1,28	1,67	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	36,61
PBPSSH Partia Bashkimi Popullor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4,35
PDIU Partia Drejtësi, Integrim dh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3,48
PBDNU Partia për Bashkimin dhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,67
PDS Partia Democracia Sociale	0	0	0	0	1,38	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,38
PD -AN Partia Demokratike - Alex	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,05
Parti të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0,45	0	0	0,45
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0,32	0,32
Totali	141,74	119,53	116,3	99,4	91,91	85,45	83,85	78,95	76,15	67	63,35	44,55	40,83	7,06	5,9	2,15	

Autoriteti Mediave Audiovizive
 Aktori - Lajme
 Koha sinkron në minuta
 26/03/2021 - 03/04/2021

TABELA NR.1.1

Aktori	Apollon	Shtjakk TV	Rozafa tv	Ziarr TV	Alpo TV	Re AI	Klan News	Syri TV	Skampa	Report TV	Euronews	News 24	A2 CNN	Klantv	Top News	Scan	Vizion Plus
Edi Rama	119,25	48,62	32,83	34,87	0	4,62	68,1	47,88	0	40,72	36,82	47,85	36,27	42,57	39,87	23,6	32,67
Lulzim Basha	10,42	66,55	18,18	53,63	11,4	22,55	39,13	31,18	0	8,38	45,68	34,73	33,08	32,68	31,6	22,5	30,27
Monika Kryemadhi	0	49,95	4,35	22,38	0	0	12,3	8,58	0	6,52	13,95	7,22	20,43	5,33	0	0	3,8
Taulant Balla	23,08	0	0	17,85	0	0	4,67	4,3	73,15	15,5	0	4,17	4,03	0,57	0,67	0	9
Fatmir Mediu	0	14,88	63,63	8,17	0	0	0	3,07	0	13,28	0	0	1	0	0	0	0
Damian Gjiknuri	49,93	0	0	6,95	0	36,35	0	1,5	0	2,33	0	0	0	0	0	0	2,65
Bujar Leskaj	50,1	0	0	0,48	0	28,93	0	6,85	0	0,42	0	0	0	0	0	0	2,45
Bledi Çuçi	0	0	0	0	89,43	0	0	0	0	0	0,43	0	0	0	0	0	0,33
Gazmend Bardhi	0	0	0	8,17	0	0	0	2,15	62,08	10,37	0	0	2,6	0	0	0	0
Erion Veliaj	15,87	4	0	5,57	0	0	9,63	0	0	4,12	0	0	0	8,3	3,73	0	6,4
Luan Baci	49,03	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ogerta Manastirliu	5,67	8,67	1,4	0	0	0	4,43	0,33	0	1	2,9	0,87	0,43	3,53	0	11,2	0,38
Vojo Bregu	0	6,4	0	2,95	0	0	0	6,25	0	0	2,87	3,93	0	0	4,47	0	0
Trilan Shehu	0	0	0	0	31,47	0	0	1,17	0	1,7	0	0	0	0	0	0	0
Ilir Beqaj	0	0	32,5	0	0	0	0	0,5	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bardh Spahia	0	1,55	17,47	0	0	0	0	4,5	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Perrit Vasili	0	6,13	0	6,7	0	0	0	4,17	0	0	0	0,6	0	0	0	0	0
Voltana Ademi	0	0	18,5	0	0	0	0	1	0	0	0,58	0,62	0	0	0	0	0
Halit Valteri	16,92	0	0	0	0	0	0	0	0	1,2	0	0	0	0	3,65	0	0
Jozeфина Topalli	0	0	0	0	0	8,32	0	0	0,9	2,33	0	0	1,33	0	0	0	1,33
Vangel Tavo	0	0	0	4,3	5,73	0	0	0,83	0	2,25	0	2,38	0	0	0	0	0
Agron Duka	0	7,48	0	0	0	0	0	2	0	6	0	3,42	0	0	0	0	0
Ivi Kaso	0	0	0	0	0	0	0	5,33	0	0	2,5	1,45	6,03	1,32	0	0	0
Myzafer Elezi	0	0	0	0	19,55	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Anila Denaj	0	0	0	0	0	0	3,5	0	0	1,35	3,95	0,7	0	0	0	0	0
Ardian Kollozi	0	0	0	0	0	18,43	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,92	1,23
Niko Peleshi	15,18	0	0	0	0	0	0	1,17	0	1,13	0	0	0	0	0	0	0
Agron Gela	0	0	17,4	0	0	0	0	0	0	0	2,82	0	0	2,2	0	1,25	0
Belinda Balluku	0	0	0	0	0	0	2,27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tom Doshi	0	0	0	0	0	0	0	1,23	3,1	0,43	0	0,73	0,45	0	1,35	0	0
Eridian Sallanji	0	0	0	0	0	0	0,83	0,17	0	0	1,25	1,15	4,25	0,47	0	0	0,72
Sali Berisha	0	0	0	0	0	0	6,63	3,25	0	0	0	0	0	3,18	0	0	0



Autoriteti Mediave A
 Aktori - Lajme
 Koha sinkron në mini
 26/03/2021 - 03/04/

TABELA NR.1.1

Aktori	Fax News	Bulgiza TV	Ora News	RTSH 1	Abc News	Rtv Ora	Top Channel	Klan Plus	MCN	RTSH 24	Adrianet	Kanali 7	Radio Tirana	RTSH 2	Berati Tv	tar	t
Edi Rama	26,12	19,68	18,28	24,73	20,13	18,8	18,15	14,6	7,55	17,93	6	10,93	10,62	6,1	6,38	0,62	
Lulzim Basha	16,65	18,92	19,72	23,85	16,05	18,2	19,5	14,2	7,32	12,1	10,6	8,63	10,78	6,57	6,85	0,93	
Monika Kryemadhi	6	2,35	9,5	3,15	1,22	7,4	0,65	4,22	0	1,42	0	1,63	3,23	2,2	0	0	
Taulant Balla	5,83	2,05	2,93	0	0	2,07	0,32	2,43	2,17	0	3,47	3,1	0,63	0	0	0	
Fatmir Mediu	5,87	4,53	7,33	3,2	5,97	1,6	0	0	0	2,95	0	0	1,62	9,47	0	0	
Damian Gjiknuri	0	0	3,52	0	0	0,47	0	0	1,3	0	0	0,95	0	0	0	0	
Bujar Leskaj	0,5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0,95	0	0	0	0	
Bledi Çuçi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Garmond Bardhi	0,73	0	0,63	0	0	0,33	0,32	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Erion Veliaj	0,47	0	0	0	0	0	2,07	4,57	0	0	0	1,08	0	0	0	0	
Luan Baçi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Ogjeta Manastirliu	1,33	0	0,27	1,57	0	0,33	0	0,6	0	0	0	0	0	0	0	0	
Vojo Bregu	5,95	3,2	0	0	3,2	0	0	0	0	0	0	0	0,65	0	0	0	
Tritan Shehu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Ilir Beqaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Bardh Spahia	0,53	0	1,73	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Petrit Vasili	1,3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3,4	0	0	0	0	0	
Voltana Ademi	0	0	0	0	1,37	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Halit Valteri	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Jozefina Topalli	2,78	2,25	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Vangjel Tavo	1,35	0	0	0	0	0	0	1,6	4,2	0	0	0,78	0	0	0	0	
Agron Duka	0	0	1	0	0	0	0	0,83	0	0	0	0	0	0	0	0	
Ivi Kaso	0	0,3	0	0	0,85	0,33	0,55	0	1,7	0	0	0	0	0	0	0	
Myzafer Elezi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Anita Deraj	0	0	1,87	0,83	0,25	0,77	0	0	0	0,82	0	0	0	0,8	0	0	
Ardian Kollozi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Niko Pelesh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Agron Çelaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Belinda Balluku	0	0	0	5,18	0	0	0	0	0	0,78	0	0,62	0	1,45	0	0	
Tom Doshi	2,5	0	1	0	2,2	0,47	0,68	0	1,32	0	0	0	0	0	0	0	
Eridan Sallianji	0,4	1,1	0,88	0	1,13	0	0,53	0	0	0	0	0,28	0	0	0	0	
Sali Berisha	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	



Autoriteti Mediave Audiovizive

Subjekti - Emisione

Koha e plotë në minuta

26/03/2021 - 03/04/2021

TABELA NR. 2

Subjekti	Euronews	RTSH 24	Report TV	News 24	Abc News	MGN	Rtv Ora	Shijak	RTSH 1	Syri Tv	Top Channel	Fax News	Klan Plus	A2 CNN	Vizion Plus
PS Partia Socialiste	1223	483	390	357	298	66	316	0	240	101	521	103	351	157	263
PD Partia Demokratike	536	554	306	385	356	121	167	422	139	256	57	296	133	158	79
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	65	0	22	87	57	341	136	319	64	100	0	127	19	37	62
BD Partia Binda Demokratike	0	0	0	45	35	0	44	0	103	0	0	0	12	54	53
LN Lëvizja për Ndryshim	0	0	0	45	43	307	24	0	0	0	0	0	12	26	0
NTH Nisma Thurje	42	0	0	0	0	0	0	0	123	0	0	0	12	23	43
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	32	0	0	0	0	0	0	174	0	0	0	17	0
PDIU Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0	30	0	100	6	0	0	0	0	19	0	0	0	0
PSD Partia Social Demokratike	0	0	2	0	0	0	0	0	0	28	0	0	12	0	0
PBK Partia Balli Kombëtar	0	0	0	0	0	0	110	0	0	0	0	0	0	0	0
D Kandidat i Pavarur	0	0	89	0	0	6	0	0	0	0	0	0	0	13	0
PR Partia Republikane Shqiptare	0	0	61	0	0	6	0	0	0	0	0	18	0	16	0
PLR Partia Levizja e Re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	23	0	0	0
PAA Partia Agrare Ambientaliste	0	0	0	0	0	0	0	33	0	0	0	0	0	0	0
PLDSH Lëvizja Demokratike Shqiptare	0	0	0	0	20	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0
ADR Partia Aleanca Demokracia e re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15	0	0	10	0
PLL Partia Lëvizja e Legalitetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25	0	0	0
VV Vetëvendosja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1866	1037	932	919	909	853	797	774	676	659	612	592	551	511	500



Autoriteti Mediave Audiovizive

Subjekti - Emisione

Koha e plotë në minuta

26/03/2021 - 03/04/2021

TABELA NR. 2

Subjekti	KlanTv	Scan	Re Al	Kanali 7	Ora News	Top News	Rozafa	Adrianet	Apollon	Skampa	Alpo	RTSH 2	Klan News	Bulqiza	TOTALI
PS Partia Socialiste	148	217	86	121,5	55	88	148	52	2	0	0	0	21	0	5807,5
PD Partia Demokratike	247	148	91	68	160	89	20	99	48	88	28	0	0	0	5051
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	23	69	0	32	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1600
BD Partia Binda Demokratike	14	0	98	27	0	0	0	0	24	0	0	0	0	0	509
LN Lëvizja për Ndryshim	13	0	0	2	0	0	0	0	24	0	0	0	0	0	496
NTH Nisma Thurje	13	0	0	43	0	0	0	0	25	0	0	22	0	0	346
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	223
PDIU Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	155
PSD Partia Social Demokrate	13	0	70	0	0	30	0	0	0	0	0	0	0	0	155
PBK Partia Balli Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	110
D Kandidat i Pavarur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	108
PR Partia Republikane Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	101
PLR Partia Levizja e Re	0	0	0	0	0	0	0	0	25	0	0	0	0	0	48
PAA Partia Agrare Ambientaliste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	33
PLDSH Lëvizja Demokratike Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27
ADR Partia Aleanca Demokracia e re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25
PLL Partia Lëvizja e Legallitetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25
VV Vetëvendosja	0	0	0	0	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0	17
Totali	471	434	345	293,5	253	207	168	151	148	88	28	22	21	19	



Autoriteti Mediave Audiovizive
Subjekti - Reklama
Koha e plotë në minuta
26/03/2021 - 03/04/2021

TABELA NR.3

Subjekti	Re AI	Klan News	Klantv	News 24	Klan Plus	Abc News	Top Channel	Vizion Plus	Fax News	Top News
PD Partia Demokratike	49,05	70,03	65,32	24,22	44,75	46,27	39,02	35,72	60,55	0
PS Partia Socialiste	0	68,07	69,37	57,48	69,6	58,92	54,25	51,97	0	60,87
BD Partia Bindja Demokratike	283,6	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	0	0	0	47,25	0	0	0	0	2	0
PD -AN Partia Demokratike - Aleanca për Ndrryshim	0	0	0,58	0	0	0	0	0	0	0
Totali	332,7	138,1	135,27	128,95	114,35	105,19	93,27	87,69	62,55	60,87



Autoriteti Mediave Audiovizive
Subjekti - Reklama
Koha e plotë në minuta
26/03/2021 - 03/04/2021

TABELA NR.3



Subjekti	Report TV	Euronews	Ashijak TV	Rtv Ora	Syri Tv	A2 CNN	Rozafa	Scan	Apollon	Kanali 7	Bulqiza TV	totali
PD Partia Demokratike	0	35,3	55,07	30,58	30,58	29,92	27	26,2	18,08	9,35	1,23	698
PS Partia Socialiste	55,72	22,22	0	0	0	0	0	0	0	3,3	0,55	572
BD Partia Bindja Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	28
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	3,97	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	53
PD -AN Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	59,69	57,52	55,07	30,58	30,58	29,92	27	26,2	18,08	12,65	1,78	

Autoriteti Mediave Audiovizive
 Subjekti - gjinia - të gjitha auditet
 Koha e plotë në minuta
 03/04/2021 - 03/04/2021

TABELA NR. 4

Subjekti	News 24	Fax News	Euronews Alb	RTSH 24	Syri Tv	Klan News	Apollon	Shijak TV	RTSH 1	Top Channel	Alpo TV	Kiantv	Repor
PS Partia Socialiste	166,85	75,48	122,77	110,67	55,5	120,7	28,27	7,08	101,75	105,6	36,68	29,82	
PD Partia Demokratike	85,42	140,47	127,08	98,75	69,83	53,68	42,37	67,8	8,33	5,28	31,08	32,75	1
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	35,9	69,3	3,42	15,12	47,5	0	0	70,37	4,75	0	5,93	3,77	
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	37	0	0	0	0	0	0	0	
LN Lëvizja për Ndrryshim	0	0	0	0	0	0	24	0	0	0	0	0	
BD Partia Bindja Demokratike	0	0	0	0	0	0	24	0	0	0	0	0	
NTH Nisma Thurje	0	0	0	0	0	0	25	0	0	0	0	0	
PLR Partia Levizja e Re	0	0	0	0	0	0	25	0	0	0	0	0	
PR Partia Republikane Shqiptare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
PSD Partia Social Demokrate	0	0	0	0	14	0	0	0	0	0	0	0	
Totali	288,17	285,25	253,27	224,54	223,83	174,38	168,64	145,25	114,83	110,88	73,69	66,34	6
% Meshkuj	89,62	74,65	98,65	93,71	80,79	93,69	52,56	51,55	54,06	69,34	91,95	92,67	8
% Femra	10,38	25,35	1,35	6,29	19,21	6,31	47,44	48,45	45,94	30,66	8,05	7,31	1



Autoriteti Mediave Audiovizive
 Subjekti - gjinia - të gjitha auditet
 Koha e plotë në minuta
 03/04/2021 - 03/04/2021

TABELA NR. 4

Subjekti	Rozafa tv	Ora News	Top News	Zjarr Tv	Bulgiza TV	Skampa	Abc News	A2 CNN	Vizion Plus	Rtv Ora	Kanali 7	MCN	Radio Tir
PS Partia Socialiste	20,53	11,92	36,4	13,15	12,13	13,07	15,92	10,65	9,67	6,9	6	1,6	
PD Partia Demokratike	18,6	2	3,53	16,37	20,13	13,73	3,6	6,55	4,5	4,13	2	0	
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	8,67	36,93	0	5	0	0	5	5,4	0	0,87	0	0	
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
LN Lëvizja për Ndryshim	0	0	0	0	1,62	0	0	0	0	0	1	3,75	
BD Partia Bindja Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,77	
NTH Nisma Thurje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
PLR Partia Levizja e Re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
PR Partia Republikane Shqiptare	11,73	5,45	0	0	0	0	0	0	0	1,83	0	0	
PSD Partia Social Demokrate	0	0	0	2,35	0	0	0	0	0	0	0	0	
Totali	59,53	56,3	39,93	36,87	33,88	26,8	24,52	22,6	14,17	13,73	9	8,12	
% Meshkuj	89,48	52,17	100	86,44	89,46	100	79,61	76,11	100	90,02	77,78	53,8	8
% Femra	10,53	47,83	0	13,56	10,54	0	20,39	23,89	0	9,98	22,22	46,2	1



Autoriteti Mediave Audiovizive
Subjekti - gjinia - të gjitha auditet
Koha e plotë në minuta
03/04/2021 - 03/04/2021

TABELA NR. 4

Subjekti	Adrianet	RTSH 2	totali
PS Partia Socialiste	2,62	0	1161
PD Partia Demokratike	1,95	0	880,57
LSI Lëvizja Socialiste për Integrim	0	2,53	331,36
LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	37
LN Lëvizja për Ndryshim	0	0	30,37
BD Partia Binda Demokratike	0	0	26,77
NTH Nisma Thurje	0	0	25
PLR Partia Levizja e Re	0	0	25
PR Partia Republikane Shqiptare	0	0	19,01
PSD Partia Social Demokrate	0	0	16,35
Totali	4,57	2,53	
% Meshkuj	42,67	0	
% Femra	57,33	100	

